

## *Letër Kryepastorale e Fortlumturisë së Tij, Mitropolitit HERMAN në Festën e Lindjes së Zotit tonë*

Festa e Lindjes së Zotit tonë 2007

Vëllezër Hierarkë, të Nderuar Klerikë, të Vyer Monahë dhe të dashur Besimtarë të Kishës Ortodokse në Amerikë:

*Krishti u Lind! – Lavdërojeni!*

Në festimin e Lindjes së Zotit tonë edhe njëherë këtë vit, ne të Krishterët Ortodoksë e gjejmë veten tonë në afrimin e Festës që është shumë e ndryshme nga çka ajo është në pjesën tjetër të botës.

Tragjikisht për shumë njerëz në këtë botë, jeta e tyre është pa praninë e Perëndisë; qoftë në besimin e tyre personal, në praktikë, apo të dyja. Për të tjerët, “besimi” i tyre është në një Perëndi që në mënyrë të vështirë është i përfshirë në historinë e njerëzimit apo në jetën e tyre; ashtu siç thuhet në një këngë të mirënjohur e disa viteve të shkuara që thotë: “Perëndia është duke na vështruar ... nga largësia”. Por për ne të Krishterët Ortodoksë, prononcimi i Shkrimit të Shenjtë përsa i përket Mishërimit kumbon qartazi: “*Dhe ja, Virgjëresha do të mbarset, dhe do të lindë një Djalë, dhe emri i Tij do të quhet Imanuel, që do të thotë: ‘Perëndia është me ne’*”, (Mateu 1:23). Edhe himnografia e Festës i bën jehonë këtij proklamimi: “*Perëndia është me ne! Kuptojeni ju o kombe dhe nënshtrorjuni, se Perëndia është me ne!*”! Ai nuk “është duke na vështruar nga largësia” por “është me ne”; rreth nesh, përkrah nesh, si dhe në masën që ne dëshirojmë prezencën e Tij, përbrenda nesh, po aq afër sa dhe frymëmarrja në mushkëritë tona, apo të rrahurat e zemrave tona.

Për shumë njerëz, sot është festimi i lindjes së një foshnje të bukur, të pafajshme dhe “të tulatur”, që do të rriteshe dhe do të bënte më shumë të mira sesa çdo njeri tjetër; të bëjë të verbërit të shikojnë, të shurdhërit të dëgjojnë, ulokët të ecin, të vdekurit të ngjallen. Për disa, Ai bile ofron edhe jetën e Tij në kryq, në shkëmbim të mëkateve të njerëzve dhe për shpëtimin e tyre. Porse për ne, kjo Festë karakterizon ardhjen e mishëruar të askujt tjetër, por vetë Atij, Perëndisë. Jezu Krishti është jo vetëm thjesht njeri; Ai është Personi i Dytë i Trinisë së Shenjtë, Perëndia - Biri, **Perëndia - Fjala**: “*Dhe Fjala u bë njeri dhe u vendos ndër ne, dhe ne pamë lavdinë e Tij, lavdi si e të Vetëmlindurit prej Atit, plot me hir dhe me të vërtetë*”, (Ioan 1:14).

Pothuajse gjithkush që feston këtë ditë, e karakterizon atë me shkëmbimin e dhuratave, dhe shpeshherë njerëzit janë të fokusuar në “listën e dëshirave” të tyre, të dhuratave që ata duan të marrin nga Plaku i Krishtlindjeve dhe xhuxhat e tij. Por përqëndrimi për ne të Krishterët Ortodoksë qëndron në pyetjen që bëjmë në një prej himneve të Mbrëmësore së Krishtlindjeve:

*Çfarë të të sjellim Ty o Krisht, që për ne u shfaqe ndër dhé si njeri? Çdo krijesë e bërë prej Teje të falenderon Ty. Engjëjt të ofrojnë Ty një himn; qiejtë, një yll; Magët, dhurata; barinjët, çudinë e tyre; toka, guvën e saj; shkretëtira, grazhdin; kurse ne të ofrojmë Ty një Nënë Virgjëreshë. O Perëndi e Përrjetshme, ki mëshirë mbi ne.*



Kisha jonë Ortodokse na thëret që t'i sjellim dhuratat tona Krishtit, në vend që të presim dhurata nga të tjerët. Na kujtohen dhuratat e njerëzve të urtë, të bëra në emër të të gjithë racës njerëzore: *ar*, për të njohur sovranitetin e Mbretit të vetëm; *temjan*, si përgjnjje në shërbesën e një Perendie të vetme e të vërtetë; dhe *miro*, sepse Krishti, prurësi i Ngjalljes, do të suprimonte vdekjen, kështu që nuk kishte më nevojë për vajin që përdoreshe në varrim.

Jemi të thirrur t'i ofrojmë Perëndisë së Trupëzuar dhuratat e besimit, shpresës dhe dashurisë tonë; Ai pret pendimin tonë, rrëfimin tonë, si dhe kthimin tonë në rrugën e ngushtë që të çon në Mbretërinë e Tij; Ai do të gjithë jetën tonë, të qenit tonë në Trupin e Tij, angazhimin tonë në ngritjen e Kishës së Tij të Shenjtë. Si shpërblim për të gjitha këto dhurata, ne do të marrim atë çka humbi Adami në Parajsë: kungimin me Të! Në kthim Ai na ofron Trupin dhe Gjakun e Tij si një premtim për jetën e pasosur me Të, në Mbretërinë e Tij qiellore.

Është e vërtetë që ne jetojmë në një shoqëri të pasur, mbushur me gjërat e mira të kësaj bote që na joshin. Por Krishti na thëret për të kujtuar shembullin e Mbretit Solomon, i cili kishte pasuri të pamatshme, famë, fuqi dhe urtësi, por ishte i munduar sepse ai nuk mund të kënaqte dëshirën e zemrës së tij. Ai ishte aq i pasur saqë të gjitha orenditë e pallatit të tij ishin të mbuluara me ar; aq i urtë, saqë të gjithë udhëheqësit e kombeve merrnin këshilla prej tij; aq i fuqishëm, saqë të gjithë mbretërit e botës ja kishin frikën. Megjithatë ai ishte krejtësisht i pakënaqur, sepse ai e dinte që megjithëse mund të kishte çdo gjë që dëshironte në këtë botë, pasuria dhe fuqia ishin diçka e kotë dhe e zbrazët; puse të thata që nuk mund ta shuanin etjen e tij për të hyjnishmen. Ai nuk mund të kënaqte një dëshirë të vërtetë të zemrës së tij sepse ai nuk mund të rivendoste kungimin me Perendinë që Adami e pat humbur.

Le të vemë vëmendjen tonë tek urtësia e Solomonit dhe të pranojmë se të gjitha gjërat e kësaj bote nuk mund të shuajnë etjen e zemrës njerëzore. Dhe së bashku me Magët, le të shikojmë për Atë që erdhi në botë për të rivendosur kungimin me Perendinë që njeriu e kish humbur. Duke i ofruar veten tonë Atij dhe Kishës së Tij, në formën e dhuratave të kohës, të dhuntive dhe të thesareve, le të ripërtërijmë besën, shpresën dhe dashurinë tonë në Krishtin i Cili, nëpërmjet Trupëzimit të Tij hyjnor, na dha dhuratën e jetës së pasosur, secilit prej nesh dhe të gjithë racës njerëzore.

Duke shpresuar që Zoti t'ju mbushë me të gjitha gëzimet në këtë periudhë Krishtlindjesh dhe në Vitin e Ri që po vjen dhe me dhënien e bekimeve tona kryepastorale, mbetem i juaji

Me dashuri në Foshnjën Mesia,

+ H E R M A N



Kryepeshkop i Uashingtonit dhe Nju Jorkut  
Mitropolit i Gjithë Amerikës dhe Kanadasë